



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.1465/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit-propozuesit të sigurimit EKSIM COM shpk me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson me autorizim avokati J.O nga Prishtina kundër të paditurës-kundërshtarit të sigurimit Korporata Energjetike e Kosovës sh,a me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim J.M, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.115/22 e datës 20.05.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 19.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË ankesa e propozuesit të sigurimit EKSIM Com shpk nga Prishtina, e ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.115/22 e datës 20.05,2022, si e PALEJUESHME

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktvendimin e ankimuar I.EK.nr.115/22 e datës 20.05.2022, ka vendosur që të refuzon si të pabazuar propozimin e propozuesit të sigurimit EKSIM COM shpk nga Prishtina, i paraqitur kundër kundërshtarit të sigurimit Korporata Energjetike e Kosovës sh,a me seli në Prishtinë, me të cilin ka propozuar që ti ndalohet ekzekutimi i kontratës me numër KEKO-20-284-121 në shumën e tërësishme prej 6,831.73€ sipas policës së lëshuar nga kompania e sigurimeve nr. ... dt.04.10.2021, e deri në marrjen e vendimit të plotfuqishëm lidhur me çështjen juridike kontestimore.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur i autorizuari i propozuesit të sigurimit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim i gabuar i të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, dhe të ndryshohet aktvendimi I.EK.nr.115/22 e datës 20.05.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, të aprovohet propozimi i propozuesit të sigurimit dhe caktohet masa e sigurisë ashtu që ti ndalohet kundërshtarit të sigurimit që të bëjë ekzekutimin e sigurimit të kontratës nr.KEKO-20-284-121 në shumën e tërësishme prej 6,831.73€ sipas policës së lëshuar nga Kompania e Sigurimeve Siguria, me nr police ... dt.04.10.2021.

E paditura-kundershtari i sigurimit në përgjigjen në ankesë datë 21.06.2022 deklaroi se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të propozuesit, pasi që nuk jepen argumente të reja që kishin me e bërë ankesën e bazuar. Gjykata me të dejt ka refuzuar propozimin e siguruesit. Propozuesi nuk ka arrit që me prova ta arrij besueshmërin dhe themelsin e kërkesadis, dhe nuk mund të pranohet pretendimi i propozuesit se kundershtari i sigurimit në mënyrë të njëanshme e ka shkëputur kontratën. I propozojm gjykatës së shkallës së dytë ta refuzoj si të pabazuar ankesën dhe ta vërtetoj aktvendimin I.EK.nr.115/2020 dt.20.05.2022 i Gjykatës Themelore ne Prishtinë-Departamenti për qështje ekonomike.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pa lejueshme

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, fillimisht e vlerësoj afatshmërinë e ankesës dhe gjeti se ankesa e të autorizuarit të propozuesit të sigurimit është e pasafatshme sepse aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, i autorizuari i propozuesit e ka pranuar me datën 23.05.2022, rrethanë e cila konfirmohet nga fletë dorëzimi në shkresat e lëndës, ndërsa ankesën i autorizuari i propozuesit e ka paraqitur me datën 01.06.2022, e konfirmuar nga vula e pranimit në Gjykatë. Duke qenë se i autorizuari i propozuesit, aktvendimin e atakuar e ka pranuar me datën 23.05.2022, rrjedh së dita e fundit e afatit për paraqitjen e ankesës ka qenë data 30.05.2022, ndërsa ankesa është paraqitur me datën 01.06.2022 që nënkupton se ankesa është parashtruar pas kalimit të afatit ligjor të paraparë me nenin 509 pika c) e LPKsë,që parashihet se: “kundër aktvendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, palët mund të bëjnë ankim brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktvendimit,

Për të vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, ju referua dispozitave të LPK-së, nga neni 186 paragrafi 2, me të cilën përcaktohet së: “*ankesa është e pa afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj*” ndërsa me dispozitën e nenit 196 të LPK-së, parashihet së: “*ankesën e vonuar, jo të plotë, apo jo të lejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë, me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç parashihet me nenin 186*”.

Nga arsyet e mësipërme, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi pasi që gjeti së ankesa e propozuesit të sigurimit është e pasafatshme, të cilën kjo gjykatë e hedhi poshtë në pajtim me nenin 196 dhe 209 pika (a) të LPK-së, duke vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II nr.1465/22 datë 19.09.2022

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari

Krenar Berisha